



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:110150
Datë: 12.08.2024
Numri i dokumentit: 06039484

CAP.nr.1260/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtarja individuale Frosina Sylejmani, me bashkëpunëtorin profesional Kastriot Makolli, në çështjen juridike përmbartimore të kreditores N.K, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Bashkim Iljazi jurist nga Gjilani, kundër debitorit Komuna e Gjilanit, të cilën e përfaqëson Burim Maliqi, Zyrtar i Lartë Ligjor i Komunës së Gjilanit, me objekt të përmbartimit kërkesë në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, CPK.nr.42/23 i datës 01.08.2023, me datë 12.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Komuna e Gjilanit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, CPK.nr.42/23 i datës 01.08.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar CPK.nr.42/23 i datës 01.08.2023, në pikën I të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e datës 08.05.2023 të debitorit Komuna e Gjilanit të paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.181/23 i datës 04.05.2023 lëshuar nga Përmbartuesi Privat Besnik F. Nuhiu nga Gjilani dhe i njëjti urdhër mbetet në fuqi. Në pikën II të dispozitivit ka obliguar debitorin që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 624 euro, në emër të përpilimit të propozimit për përmbartim dhe përgjigjen në prapësim.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor kanë parashtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të refuzohet propozimi për përmbartim apo prishet aktvendimi i ankimuar dhe rasti të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar kreditori me propozim që të refuzohet në tërësi e pabazuar ankesa e debitorit Komuna e Gjilanit ndërsa aktvendimi i ankimuar CPK.nr.42/23 të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208, 209 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se me Urdhrin e Përmbartuesit Privat Besnik F. Nuhiu me seli në Gjilan P.nr.181/23 të datës 04.05.2023, është caktuar përmbartimi në dobi të kreditorit N.K, ndaj debitorit Komuna e Gjilanit, në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilani C.nr.461/2018 i datës 22.03.2022 si dhe Aktgjykimit të vërtetuar të Gjykatës së Apelit në Prishtinë Ac.nr.4240/2021 të datës 04.04.2023 i formës së prerë më datën 04.04.2023 dhe i ekzekutueshëm më datën 28.04.2023, për realizimin e kërkesës në të holla në shumë prej shumë prej 13,797.00 euro (trembëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë euro), si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër këtij urdhri mbi lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin ka kërkuar që të refuzohet propozimi për ekzekutim P.nr.181/23 i datës 04.05.2023 dhe të anulohen të gjitha veprimet në lidhje me objektin e këtij propozimit. Më tej ka theksuar se kjo lëndë gjendet në Gjykatën Supreme për të vendosur sipas revizionit, andaj me qëllim që të ketë një zgjidhje të drejtë të këtij rasti konsideron se duhet të presë vendimin final nga Gjykata Supreme për të implementuar eventualisht këtë propozim për përmbartim në bazë të dokumentit përmbartimor. Ka propozuar që ta aprovon prapësimin e debitorit Komuna e Gjilanit dhe të shtyhet pezullimi deri në vendimin final të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditorja përmes të autorizuarit të saj duke i kundërshtuar pretendimet e debitorit duke shtuar se pretendimet e debitorit se kjo lëndë gjendet për vendosje në Gjykatën Supreme nuk qëndrojnë ngase neni 213 i LPK-parasheh se: “ Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbartimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur me revizion” andaj nuk është bazë as për shtyrje të procedurës së përmbartimit. Ka shtuar se prapësimi i ushtruar nga ana e debitorit nuk gjen mbështetje në asnjërën nga shkaqet e parapara në nenin 71 të LPP-së në të cilat bazohet prapësim, pasi që nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet për hedhjen e urdhrin apo anulimin e tij, i ka propozuar gjykatë që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Gjilanit, dhe ta lë në fuqi Urdhrin e Përmbartuesit Privat Besnik F. Nuhiu nga Gjilani P.nr.181/2023 të datës 04.05.2023, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës për përpilimin e propozimit për përmbartim si dhe për përpilimin e përgjigjes në prapësim me nga 312 euro për secilën parashtrësë.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim me aktvendimin CPK.nr.42/23 i datës 01.08.2023 ka refuzuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë mes tjerash ka theksuar se prapësimi i debitorit i datës. 08.05.2023 është i pabazuar, pasi që i njëjti nuk ka vërtetuar asnjërën nga shkaqet të cilat janë paraparë në nenin 71 të LPP-së lidhur me paraqitjen e prapësimin.

Gjithashtu gjykata vërtetoi faktin se propozimi për përmbarrim i paraqitur nga kreditorja i plotëson gjitha kushtet ligjore të parapara me nenin 38 të LPP-së, e po ashtu edhe dokumenti përmbarrimor – Aktgjykimi C.nr.461/2018 i datës 22.03.2021 dhe i Gjykatës së Apelit Ac.nr.4240/2021 datës 04.04.2023 i formës së prerë më datën 04.04.2023 dhe i ekzekutueshëm më datën 28.04.2023, mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarrimi, i plotëson konditat ligjore nga neni 22 par.1, pika 1.1 dhe neni 27.1, andaj nga të lartcekurat, gjykata vendosi që ta refuzojë prapësimin e debitorit dhe Urdhri i përmbarrimor P.nr.181/23 i lëshuar nga Përmbarruesi Privë Besnik F. Nuhiu më datë 04.05.2023 të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë për mënyrën e vendosjes vendimin e saj e ka mbështetur në dispozitat e nenit 5, 13, 22, 71, 72 dhe 73 të LPP-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK, dhe se drejtë materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit se aktvendimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarrimore, ku pala ankuese nuk thirret në asnjë dispozitë të LPK-së, por nga përmbajtja e ankesës ceket se aktvendimit të ankimuar i mungojnë specifikat ligjore mbi të cilat është bazuar ky aktvendim, e nga këto thënie rezulton se kemi të bëjmë më nenin 182 paragrafi 2 pika n) të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të ankimuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e dhëna, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për refuzim të prapësimin të debitorit dhe lënien në fuqi të urdhrin për përmbarrim P.nr.181/23 i datës 04.05.2023, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.461/2018 i datës 22.03.2022, i plotfuqishëm me datë 04.04.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 28.04.2023, në rastin konkret është dokument përmbarrues, kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton së: *“dokument përmbarrimor është vendimi përmbarrues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbarruese”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarrimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i po këtij ligji ku përcaktohet se: *“dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave ligjore me rastin e refuzimit prapësimin nuk qëndrojnë.

Pretendimet e debitorit për vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit, sepse në procedurën

përmbartimore Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes për prapësimin vendos duke iu përmbajtur parimit të rigorozitetit formal-juridik, që nënkupton se Gjykata do të vlerësojë shkaqet për prapësim por nuk mund të lëshohet në vlerësimet tjera që i përkasin procedurës në të cilën është nxjerr dokumenti përmbartimor.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit se në rastin konkret propozimi për përmbartim është pa bazë ligjore sepse lënda gjendet në Gjykatën Supreme sipas revizionit, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pabazuar për faktin se me nenin 213 të LPK-së parashihet se: “Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbartimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur me revizion” andaj nuk është bazë as për shtyrje të procedurës së përmbartimit.

Gjykata e Apelit i ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera ankimore të debitorit por të cilat nuk kanë qenë me rëndësi vendimtare për të vendosur ndryshe nga ajo që ka vendosur gjykata e shkallës së parë dhe se për këtë arsye gjykata ankimore ka vendosur që t’i refuzojë ndërsa aktvendimin e ankimuar ta vërtetoj.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1260/2023, me datë 12.08.2024

Gjyqtarja,
Frosina Sylejmani